



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DREJTORIA E PROKURIMEVE



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e Operatorëve ekonomik “KOMBEAS” SH.P.K & “ARJEIL SH.P.K Përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.3986 rep. dhe nr.4977 kol. nga shoqëria “KOMBEAS” SH.P.K. me NIPT K88103301J me administrator, Z.Astrit Nabolli, me seli në Adresën: Lezhe,Milot,Prozhme,Fshati Prozhme, Rruga Dod Llesh, në pasurine me nr.6/50, Zona Kadastrale 3441.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”

Objekti i kontratës: “Ndërtim rrjet ujësjellësi dhe kanalizime në zonën e Lanabregasit, Faza II”

Numri i referencës së procedurës: REF-67644-05-08-2018

Fondi limit: 64.369.208 (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 120 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë.

Data e zhvillimit të tenderit është: 22.06.2018 në orën 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: [Nr. 19 DATE 14.05.2018](#)

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. B.O.E “DAJTI PARK 2007” SH.P.K
& NIKA” SH.P.K.

NIPT-i K11507003S
NIPT-i J76705047U

Vlera: 48.684.511 (dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. B.O.E “S I R E T A 2F” sh.p.k.
“ARTYKA II” sh.p.k

NIPT-i K51501008J
NIPT-i K26625603U

Vlera: 54.601.953 (pesëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,
Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.

3. B.O.E **“COLOMBO” SH.P.K** NIPT-i J82916489E
“ALUERA SH.P.K NIPT-i K33222403W
Vlera: 55.014.003 (pesëdhjetë e pesë milion e katërmëdhjetë mijë e tre) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik **“SENKA” sh.p.k** NIPT-i J94808405Q
Vlera: 56.194.845 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik **“VIANTE KONSTRUKSION” SH.P.K** NIPT-i K47103804L
Vlera: 57.020.101,95 (pesëdhjetë e shtatë milion e njëzetë mijë e njëqind e një presje nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
6. B.O.E **“KOMBEAS” sh.a.** NIPT-i K88103301J
& **“ARJEIL” shpk** NIPT-i K31320002C
Vlera: 59.505.757 (pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
7. Operatori ekonomik **“SHANS INVEST” SH.P.K** NIPT-I J61924002T
Vlera: **59.962.224** (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzetë e katër) **lekë pa TVSH.**
8. Operatori ekonomik **“A.N.K” shpk** NR NIPT-i J92408001N
Vlera: 62.890.302 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e dy) lekë pa TVSH.
9. Operatori ekonomik **“LIQENI VII” sh.p.k** NIPT-i K01730502W
Vlera: 62.890.302 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e dy) lekë pa TVSH.
10. Operatori ekonomik **“BIBA-X” sh.p.k.** NIPT-i K32618815N
Vlera: 64.368.021 (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëzet e një) lekë pa TVSH.

Të skualifikuar:

1. **Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve B.O.E “DAJTI PARK 2007” SHP.K & NIKAI SH.P.K**, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 2486 rep dhe nr.984 kol datë 19.06.2018, nga shoqëria **“DAJTI PARK 2007” SHP.K** me vlerë të ofertës 48.684.511 (dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **32.184.604** (tridhjetë e dy milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.***
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **128.783.416** (njëqind e njëzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjet) lekë pa TVSH.***

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:***
 - 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:***
 - 2. Kontratë***
 - 3. Situacionin përfundimtar;***
 - 4. Aktin e kolaudit;***
 - 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim.***
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:***
 - 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:***
 - 2. Kontrate;***
 - 3. Situacionin përfundimtar;***
 - 4. Akt kolaudimi objekti;***
 - 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;***
 - 6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.***

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shoqëria “**DAJTI PARK 2007**” SHP.K ka paraqitur elektronikisht për të përmbushur kriterin e mësipërm kontratat si më poshtë:

1- Kontrata me nr. Prot 270/9 e datës 12.09.2017 me objekt “Rikonstruksion i pesë godinave ekzistuese dhe ndërtimi i sistemit të ngrohjes në QKP. Azilkërkuesit në Babrru” me vlerë të saj 61.986.805.8 lekë pa TVSH.

2- Kontrata me nr. Prot., 2250 datë 07.09.2016 “ Ndërtim K.U.Z Fshati Strum” me vlerë kontrate 14.503.314 lekë pa TVSH, e cila është realizuar nga B.O.E “Glavenica sh.p.k & “DAJTI PARK 2007” SHP.K ku shoqëria “DAJTI PARK 2007” SHP.K ka realizuar 55% të punimeve në vlerën 7.976.822,7 lekë pa TVSH.

3- Kontrata me nr.prot 2395 e datës 20.06.2016 “Sistemim-asfaltim rruga e rezervave Halil” me vlerë të kontratës 10.304.531 lekë pa TVSH.

4 - Kontrata me nr. Prot., 6020 datë 29.06.2016 “ Ndërtim I ri i kopshtit “7 Marsi” me vlerë kontrate 25.130.542.5 lekë pa TVSH, e cila është realizuar nga B.O.E “Compani Riviera 2008” sh.p.k & “DAJTI PARK 2007” SHP.K ku shoqëria “DAJTI PARK 2007” SHP.K ka realizuar 53.2% të punimeve në vlerën 13.369.448,6 lekë pa TVSH.

5- Kontrata me nr.ref.40 e datës 31.08.2015 “Rikonstruksion I shkollës 9-vjecare Fshati Sheq Musalala, Komuna Frakull” me vlerë kontrate 16.010.614 lekë pa TVSH e cila është realizuar nga B.O.E “Glavenica sh.p.k & “DAJTI PARK 2007” SHP.K ku shoqëria “DAJTI PARK 2007” SHP.K ka realizuar 63.5% të punimeve në vlerën 10.166.739,9 lekë pa TVSH.

6- Kontrata me nr.prot 7123/7 e datës 20.10.2016 “Ndërtim I rrjetit TM 20KV për furnizimin e kabinës e re Tip Box (Xhamia popullore) në fiderin A.12, Nënstacioni Rajonal dhe rrjetit TU ABC” me vlerë të kontratës 10.998.753 lekë pa TVSH.

7- Kontrata me nr.prot 6059/1 e datës 23.12.2015 “Rrethim I jashtëm I garnizionit Qëndër dhe depove të armatimit- monucionit Zall-Her” me vlerë të kontratës 20.162.209 lekë pa TVSH.

8- Kontrata me nr.prot 671 e datës 13.01.2017 “Mbyllje kanali “Kashta e Kumrit” Lgj 15. me vlerë të kontratës 5.691.700 lekë pa TVSH.

Pra sa më sipër cituar shoqëria “DAJTI PARK 2007” SHP.K në kontratat e paraqitura për plotësimin e kriterit mbi përvojën e mëparëshme si punë të ngjashme nuk ka paraqitur asnjë kontratë me objekt Ndërtim ose Rikonstruksion Rrjet ujësjellësi dhe si rrjedhojë përkatësisht duke ju referuar Preventivit të këtij objekt prokurimi “DAJTI PARK 2007” SHP.K si përfaqësues I B.O.E “DAJTI PARK 2007” SHP.K & NIKA” SH.P.K nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme me zërat në preventive. Duke qënë se në kontratën e bashpunimit të OE me Nr. 2487 rep., Nr. 895 kol. Datë 19.06.2018 palët marrin përsipër ndarjen e punimeve:

60% të punimeve do të kryhen nga operatori “DAJTI PARK 2007” SHP.K dhe 40% të punimeve do të kryhen nga operatori “NIKA” SH.P.K, nga ku rezulton se OE “DAJTI PARK 2007” SHP.K ka marrë përsipër të realizoj zëra të punimeve, të cilat nuk rezultojn të jenë me natyrë të ngjashme në asnjë nga kontratat sipërcituara të paraqitura prej tij.

Si rrjedhojë ky OE nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket Përvojës së suksesshme në realizimin e Kontratave pune të ngjashme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 1/a dhe pika 1/b, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu

VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 3205 rep dhe nr.3578 kol datë 21.06.2018, nga shoqëria “S I R E T A 2F” sh.p.k me vlerë të ofertës 54.601.953 (pesëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 0.25 m3 me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera

Bashkimi I Operatorëve ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k & “ARTYKA II” sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion me targa AA891NR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **19.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
2. Kamionçinë me targa AA4694P me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.1 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1-2 ton)**
3. Kamion me targa AA663LD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **12.1 Ton**
4. Kamionçinë me targa AA209PT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.87 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1-2 ton)**
5. Kamion me targa DV3041A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
6. Kamion me targa DV3043A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **10.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
7. Kamionçinë me targa DV3039A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1-2 ton)**
8. Kamion me targa DV3229A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **9.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamion **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga tre kamiona ka paraqitur vetëm dy kamiona me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton për secilin kamion te kërkuar nga AK (3 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “COLOMBO” SH.P.K & “ALUERA SH.P.K, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. 2079 rep dhe nr.947 kol datë

21.06.2018, nga shoqëria “**COLOMBO**” SH.P.K me vlerë të ofertës 55.014.003 (pesëdhjetë e pesë milion e katërmëdhjetë mijë e tre) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

Operatori ekonomik “ALUERA SH.P.K në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur Mjekun T.XH me të cilin **Operatori ekonomik** “ALUERA SH.P.K më datë 01.06.2018 ka lidhur Kontratën Vullnetare të punësimit.

Nga sa më sipër Mjeku T.XH nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë konformë kriterit të mësipërm të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me *Mjekun* do të konsiderohet **i pavlefshëm**.

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:*

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit

Nga shqyrtimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i bëri dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të app-së rezulton se Bashkimi I operatorëve “COLOMBO” SH.P.K & “ALUERA SH.P.K

Bashkimi I operatorëve ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri si më poshtë:

S.M manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

M.R manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

F.L manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

L.D manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)

Sa më sipër Operatori Ekonomik **nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmi drejtimi të vlefshme për automakinist**

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga B.O.E “COLOMBO” SH.P.K & “ALUERA SH.P.K është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist (copë 1) të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër B.O.E “COLOMBO” SH.P.K & “ALUERA SH.P.K nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- 4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k,** me vlerë të ofertës 56.194.845 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- **Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Shtojca11 (Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik) kërkohet të plotësohet një deklartat për kontratat e lidhura/ ose në proces.**

Ne deklaratën mbi kontratat e lidhura dhe/ose në process shoqëria Senka sh.p.k nuk ka deklaruar asnjë kontratë të lidhur apo në proces. Sipas verifikimeve të KVO në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në Buletinet e Njoftimeve Publike të APP rezultoi si më poshtë :

a) Me datë 14.05.2018 shoqëria Senka sh.p.k ka nënshkruar kontratën me Autoritetin Kontraktor Bashkia Vore me objekt **“Shtesë uji (pus shtesë) për Ujësjetësin Rajonal në Bashkinë Vorë, Njësia Administrative Prezë, Bashkia Vorë”** me vlerë kontrate 51,167,755 leke pa TVSH dhe afat

punimesh 180 ditë. (Buletini Nr.21 date 28.05.18 fq 400)

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 11 , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “VIANTE KONSTRUKSION” SH.P.K me vlerë të ofertës 57.020.101,95 (pesëdhjetë e shtatë milion e njëzetë mijë e njëqind e një presje nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

2. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 0.25 m3 me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 copë	Pronësi ose me qera

Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “VIANTE KONSTRUKSION” SH.P.K në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon “*Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion*” mjetet e mëposhtëme:

- Autovinç / Kamion me targa AA 325 CF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6 Ton. (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 5 ton dhe max 10 T)**
- Autovinç / Kamion me targa AA 736 CU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.8 Ton (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 5 ton dhe max 10 T)**
- Autovinç / Kamion me targa AA 917 JX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.8 Ton. i cili nga dokumentacioni i paraqitur në sistem nga ana e operatorit ekonomik është i vendosur në shtojcën nr.10 por nuk janë paraqitur asnjë dokument që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga tre kamiona ka paraqitur vetëm dy kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton secili te kërkuar nga AK (3 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k, me vlerë të ofertës 62.890.302 (gjashtëdhjetë e dy million e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e dy) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator 0.25 m3 me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1(nje) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	1 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “LIQENI VII” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

1. *Kamion me targa AA269FC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **9.8 Ton(do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)***
2. *Kamion me targa AA564PZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.7Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 15 ton dhe max 20 T)***
3. *Kamioncinë me targa DR9043D me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.7Ton(do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)***
4. *Auto vinç me targa AA583F me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur*

për këtë mjet 5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

5. *Kamion me targa AA247OI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)*
6. *Kamion me targa KR7924A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24.8 Ton*
7. *Kamion me targa TR0741K me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10.8 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)*
8. *Kamioncinë me targa AA638KT me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.84 Ton (do të konsiderohet i rregullt i përket kategorisë kamion me kapacitet min 1 ton dhe max 2 T)*
9. *Eskavator me goma me targa ACTM58*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton dhe maksimumi 20 ton për secilin kamion të kërkuar nga AK (2 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy **eskavator 0.25 m3 me goma** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm një eskavator 0.25 m3 me goma të kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me eskavatorin 0.25 m3 me goma të kërkuar nga AK (2 cope) , **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BIBA-X” sh.p.k, me vlerë të ofertës 64.368.021 (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëzet e një) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“BIBA-X” sh.p.k** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë të kërkuar në Shtojcën 12, të

dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e dokumentacionit u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“BIBA-X” sh.p.k** s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Bashkimin e Operatorëve ekonomik “KOMBEAS” SH.P.K & “ARJEIL SH.P.K Përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.3986 rep. dhe nr.4977 kol. nga shoqëria “KOMBEAS” SH.P.K. me NIPT K88103301J me administrator, Z.Astrit Nabolli me vlerë të ofertës 59.505.757 (pesëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.07.2018

Ankesa: Është paraqitur ankesa nga operatori ekonomik **B.O.E “DAJTI PARK 2007” SH.P.K & NIKA” SH.P.K** me Nr. K-3062 Prot. Datë 11.07.2018, nga **B.O.E “COLOMBO” SH.P.K & “ALUERA SH.P.K** me Nr. K-3035 Prot. Datë 10.07.2018 dhe nga **“S I R E T A 2F” SH.P.K** me Nr. 17522 Prot. Datë 11.07.2018 me anë të së cilave kundërshtojn vlerësimin e ofertave për këtë objekt prokurimi duke kërkuar rivlerësimin e ofertave.

Ankesave të mësipërme u është kthyer përgjigje me ane të shkresave me Nr. K-3062/1 Prot. Datë 11.07.2018, me Nr. K-3035/1 Prot. Datë 10.07.2018 me Nr. 17522/1 Prot. Datë 11.07.2018. duke mos pranuar ankesat e paraqitura prej tyre.

Gjatë afatit kohor për ankesa në KPP është paraqitur ankesë nga B.O.E “DAJTI PARK 2007” SH.P.K & NIKA” SH.P.K.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr. 618 datë 20.09.2018 vendosi: *“Të mos pranoj ankesën e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “DAJTI PARK 2007” SH.P.K & NIKA” SH.P.K [...]”*

2.Autoriteti Kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së Prokurimit”

